



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 gusht 2023
Nr. ref.: AGJ 2248/23

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI206/21

Parashtrues

Ukë Salihi

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 584/2020 të 22 prillit 2021

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Radomir Laban, gjyqtar
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ukë Salihi me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 584/2021 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) të 22 prillit 2021 si dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac. nr. 2046/17 (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) të 9 korrikut 2020. Parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme më 16 shtator 2021.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 01/2023, është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit. Për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese gjatë shqyrtimit të kërkesës i referohet dispozitave të Rregullores së sipërpërmendur. Në këtë drejtim, në pajtim me rregullin 78 (Dispozita kalimtare) të Rregullores së punës nr. 01/2023, përjashtimisht, disa dispozita të Rregullores së punës nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen për rastet që janë regjistruar në Gjykatë para shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe në masën që ato janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 19 nëntor 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 22 nëntor 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 23 nëntor 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, dhe të njëjtën ditë Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 30 nëntor 2021, Gjykata i dërgoi një shkresë Gjykatës Themelore në Prishtinë, përmes së cilës e njoftoi për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë fletëkthesën përmes së cilës vërtetohet se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.

10. Më 1 dhjetor 2021, Gjykata Supreme në Prishtinë dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar, ku shihet qartë se parashtruesi i kërkesës e ka pranuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 584/2021 më 16 shtator 2021.
11. Më 6 janar 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë.
12. Më 29 qershor 2022, Gjykata i dërgoi një shkresë Gjykatës Themelore në Prishtinë, nga e cila kërkoi nga e njëjta që të dorëzojë në Gjykatë të gjitha shkresat e lëndës.
13. Më 18 korrik 2022, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi në Gjykatë të gjitha shkresat e lëndës.
14. Më 8 shtator 2022, Gjykata e shqyrtoi këtë rast në seancën shqyrtuese, i cili u kthye për plotësim dhe kompletim.
15. Më 6 dhjetor 2022, Gjykata e shqyrtoi këtë rast në seancën shqyrtuese, i cili u kthye përsëri për plotësim dhe kompletim.
16. Më 12 dhjetor 2022, Gjykata i dërgoi shkresë Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, ku u kërkoi që të paraqesin në Gjykatë komente dhe arsytetime në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se parashtrësia e tij (përgjigja ndaj ankesës së avokaturës shtetërore) e 15 majit 2017, asnjëherë nuk është marrë parasysh edhe pse është pranuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë.
17. Më 13 dhjetor 2022, Gjykata e Apelit iu përgjigj Gjykatës përmes postës elektronike se në shkresat e lëndës nuk kishte asnjë përgjigje ndaj ankesës së parashtruesit të kërkesës të 15 majit 2017 dhe se kjo çështje duhet të adresohet në Gjykatën Themelore.
18. Nga Gjykata Themelore në Prishtinë nuk është pranuar asnjë përgjigje brenda afatit të caktuar.
19. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
20. Më 5 janar 2023, Gjykata njoftoi Këshillin Gjyqësor të Kosovës në lidhje me këtë kërkesë dhe me mosreagimin e Gjykatës Themelore ndaj shkresës së Gjykatës.
21. Më 17 janar 2023, Gjykata Themelore, pas intervenimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është përgjigjur përmes postës elektronike se përgjigjen e parashtruesit të kërkesës ndaj ankesës së Avokaturës Shtetërore të 15 majit 2017 e ka përcjellë në Gjykatën e Apelit më 17 maj 2017, për të cilën ka bashkangjitur fletëkthesën me datën e pranimit (17 maj 2017) nga Gjykata e Apelit. Të njëjtën ditë, Gjykata e ka njoftuar Gjykatën e Apelit për shkresën e Gjykatës Themelore.
22. Më 18 janar 2023, Gjykata e Apelit njoftoi Gjykatën se e kishin marrë përgjigjen ndaj padisë së parashtruesit të kërkesës, por që për shkak të numrit të madh të parashtrësive që merr Gjykata e Apelit, ata nuk ia kishin dërguar atë kolegjit të apelit që kishte vendosur në lidhje me këtë rast.
23. Më 8 shkurt 2023, Gjykata e shqyrtoi këtë rast në seancën shqyrtuese, i cili u kthye përsëri për plotësim dhe kompletim.
24. Më 25 korrik 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

25. Parashtruesi i kërkesës ka punuar si punonjës civil në Policinë e Kosovës që nga 6 marsi 2006.
26. Më 12 mars 2010, me vendimin [PK nr. Ref. PK/DP/AP/2244] e Departamentit për Personel në Policinë e Kosovës parashtruesi i kërkesës është caktuar ushtrues detyre *Zëvendës Kryesues i Komisionit të Brendshëm Disiplinor* për periudhën prej 15 marsit 2010 deri më 14 qershor 2010.
27. Më 22 shtator 2010, Policia e Kosovës shpalli konkursin e brendshëm (Ref. PK/DP/AP/8237) për pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Komisionit të Brendshëm Disiplinor të Policisë së Kosovës. Në këtë konkurs ka aplikuar parashtruesi i kërkesës.
28. Më 6 tetor 2010, Policia e Kosovës përsëri shpalli konkurs për pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Komisionit të Brendshëm Disiplinor të Policisë së Kosovës, në të cilin konkurs ka aplikuar parashtruesi i kërkesës.
29. Më 11 tetor 2010, me vendimin [nr. Ref. PK/DP/AP/8650] e Departamentit për Personel të Policisë së Kosovës, pas kryerjes së procedurës së konkursit, ka përzgjedhur dhe caktuar parashtruesin e kërkesës *Zëvendës Kryesues i Komisionit të Brendshëm Disiplinor*.
30. Në dy raste (25 tetor 2010 dhe 26 nëntor 2010), Kryesuesi i Komisionit të Brendshëm Disiplinor ka kërkuar nga Policia e Kosovës që të nivelizojë pagën për parashtruesin e kërkesës, ndërsa autoritetet në Policinë e Kosovës janë përgjigjur se Ministria e Administratës Publike është përgjegjësi i vetëm për këtë çështje.
31. Më 1 korrik 2011, me vendimin [e PK-së nr. Ref. PK/DP/AP/3034] e Departamentit për Personel të Policisë së Kosovës, parashtruesi i e kërkesës u transferua nga pozita e Zëvendës Kryesuesit të Komisionit të Brendshëm Disiplinor dhe e u emërua Zëvendës Drejtor i Drejtorisë për Standarde Profesionale, në fuqi nga 04.07.2011.
32. Gjykata rikujton se në lidhje me rastin e parashtruesit të kërkesë janë zhvilluar dy procedura:
 - 1) Procedura administrative në Policinë e Kosovës lidhur me nivelizimin e pagave dhe kualifikimin e pozitës së parashtruesit të kërkesës.
 - 2) Kontesti administrativ kundër Policisë së Kosovës në lidhje me kontestin ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe Policisë së Kosovës lidhur me nivelizimin e pagës, rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve për pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Komisionit të Brendshëm Disiplinor dhe Zëvendës Drejtorit të Drejtorisë për Standarde Profesionale, të cilat i ka kryer parashtruesi i kërkesës.
- 1) Procedura administrative në Policinë e Kosovës lidhur me nivelizimin e pagave dhe kualifikimin e pozitës së parashtruesit të kërkesës**
33. Më 29 shtator 2011, parashtruesi i kërkesës iu drejtua shërbimit kompetent të Policisë së Kosovës me kërkesë për nivelizim të pagave dhe kualifikim të pozitës.
34. Më 4 tetor 2011, shërbimi kompetent i Policisë së Kosovës iu përgjigj kërkesës së parashtruesit "*Për informatën tuaj, identifikimi i vendeve të punës dhe përshkrimi i*

punës është në proces dhe përcaktimi i koeficientit për vendet e punës nga komisioni i formuar për këtë qëllim.

Pas përfundimit të punës, Komisioni do të saktësojë vendet e punës dhe më pas, së bashku me përshkrimin e punës, ato do t'i dërgohen Ministrisë së Administratës Publike për miratimin e titujve të rinj të punës. Gjithashtu, për dijeninë tuaj, në MAP ka një komision që do të vlerësojë të gjitha pozitat sipas kohëzgjatjes së punës dhe do të përcaktojë nivelin funksional dhe koeficientin e pozitës.

Nga sa më sipër, deri në përfundimin e punës së komisionit nuk mund të vlerësojmë saktë nivelin dhe koeficientin për pozitën tuaj, prandaj çdo vlerësim paraprak do të jetë i pasaktë dhe i gabuar”.

35. *Më 11 nëntor 2013, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Komisionin për Ankesa dhe Shpërblime të Policisë së Kosovës lidhur me mospërmbushjen e detyrimeve administrative nga marrëdhënia e punës nga Policia e Kosovës, me qëllim të përcaktimit të pagës në baza meritore për pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Komisionit të Brendshëm Disiplinor dhe Zëvendës Drejtor i Drejtorisë për Standarde Profesionale me kërkesën për kompensimin e diferencës në pagën bazë dhe shtesat përkatëse për të dyja vendet e punës, në mënyrë retroaktive nga data e plotfuqishmërisë së vendimit [PK nr. Ref. PK/DP/AP/2244] të Departamentit të Personelit të Policisë së Kosovës të 12 marsit 2010.*
36. *Më 20 nëntor 2013, Komisioni për Ankesa dhe Shpërblime në Policinë e Kosovës me vendimin [nr. 217-KAT-2013] e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.*
37. *Lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Komisionit të Brendshëm Disiplinor në arsyetimin e vendimit, Komisioni për Ankesa dhe Shpërblime i Policisë së Kosovës theksoi se parashtruesi i kërkesës: “pas caktimit në pozitën e Ushtrues Detyre të Zëvendës Kryesuesit të Komisionit të Brendshëm Disiplinor, efektive nga data 15.03.2010, ju është caktua paga bazë dhe shtesa në pagë si dhe shtesa në pagë, sipas sistemit të pagave dhe se të njëjtin vendim nuk e ka kundërshtuar asnjëherë në Komisionin për Ankesa dhe Shpërblime, me përjashtim se ankuesi disa herë ka bërë kërkesë në departamentin përkatës për nivelizimin e pagës sipas pozitës. Po ashtu, paneli i komisionit vlerësoi se kërkesa për nivelizim të pagës ka qenë e pabazuar, për faktin se ankuesi Salih me datë 11.10.2010 është emëruar në pozitë Zëvendës Kryesuesit i Komisionit të Brendshëm Disiplinor, pasi i është nënshtruar procedurave të konkursit, dhe kjo nënkupton se paraprakisht është pajtuar me kriteret e konkursit, duke përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e pozitës. Paneli i Komisionit vlerëson se në kohën kur janë parashtruar kërkesat për nivelizim të pagës në Departamentin e Burimeve Njerëzore nga ana e ankuesit, pozita të cilën e ka ushtrua ankuesi nuk ka qenë e aprovuar nga Ministria e Administratës Publike”.*
38. *Lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me pozitën e Zëvendës Drejtorit të Drejtorisë për Standarde Profesionale në arsyetimin e vendimit, Komisioni për Ankesa dhe Kompensim i Policisë së Kosovës deklaroi, “Sa i përket vendimit me nr. reference PK/DP/AP/3034, të datës 01.07.2011, me të cilin vendim ankuesi është emëruar në pozitën e Zëvendës Drejtorit të Standardeve Profesionale, paneli i komisionit vlerësoi se kjo pozitë në strukturën aktuale organizative të Policisë së Kosovës të aprovuar me datë 17.05.2012, është paraparë të plotësohet me të punësuar të uniformuar”.*
39. *Më 3 dhjetor 2015, Policia e Kosovës në pozitën e zëvendës drejtorit të Drejtorisë për Standarde Profesionale, zyrtarin e uniformuar të së njëjtës (me vendimin nr. 07/1-01A18314) Policia e Kosovës e transferoi parashtruesin e kërkesës në pozitën Zyrtar i*

Lartë Ligjor në Departamentin për Çështje Ligjore. Paga e parashikuar për këtë pozitë është e njëjtë me pagën e parashikuar për atë të mëparshme (Zëvendës Drejtor i Administratës për Standarde Profesionale në të cilin është emëruar parashtruesi i kërkesës me vendim të [PK-së Nr. ref. PK/DP/AP/3034] të Administratës së Personelit të Policisë së Kosovës).

2) Kontesti administrativ kundër Policisë së Kosovës në lidhje me kontestin ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe Policisë së Kosovës lidhur me nivelizimin e pagës, rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve për pozitat e Zëvendës Kryesues të Komisionit të Brendshëm Disiplinor dhe Zëvendës Drejtorit të Drejtorisë për Standarde Profesionale, të cilat i ka mbajtur parashtruesi i kërkesës

40. Më 27 dhjetor 2013, parashtruesi i kërkesës, kundër vendimit [nr. 217-KAT-2013] të Komisionit për Ankesa dhe Shpërblime të Policisë së Kosovës, parashtrroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), kundër Policisë së Kosovës me pretendimin për (i) shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, (ii) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe (ii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin për anulimin e vendimit të lartpërmendur të Komisionit për Ankesa dhe Shpërblime të Policisë së Kosovës dhe ta obligojë Policinë e Kosovës që nga data 15.03.2010 të kompensojë në mënyrë retroaktive diferencën në mes të pagës bazë dhe shtesave nga 15.03.2010 deri në ditën e nxjerrjes së aktvendimit, duke e llogaritur atë në barasvlerën e pagës bazë dhe shtesave në gradën major apo nënkolonel të Policisë së Kosovës.
41. Më 3 mars 2016, parashtruesi i kërkesës, parashtrroi kërkesë shtesë në Gjykatën Themelore për kompensimin e diferencës në të ardhurat personale për periudhën prej 15.03.2010. deri më 07.12.2015 për pozitën Ref, Nr. 07/01.-01A/8314 të 12.03.2010 dhe kërkesë për anulimin e vendimit. nr. 07/1-01A18314 të 03.12.2015 të Policisë së Kosovës.
42. Më 28 shkurt 2017, Gjykata Themelore me aktgjykimin [C. nr. 3434/13] (I) miratoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe atë vetëm për pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Komisionit të Brendshëm Disiplinor vendimi [i PK-së nr. Ref. PK/DP/AP/2244] i 12 marsit 2010 dhe (II) obligoi Policinë e Kosovës që ta kompensojë atë dhe t'ia paguaj paditësit diferencën në të ardhura personale për periudhën prej 15.03.2010. deri më 07.12.2015 kompensimin për diferencën e pagës në shumën neto 19,239,65€ dhe kamatën në shumë prej 232,37€, gjithsej 19,563,02€, diferencën në kontributin pensional prej 2,250,25€ dhe tatimin në këtë diferencë në shumë prej 2,137,74€, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 200€; dhe (III) refuzoi, si të palejueshme padinë në pjesën që ka të bëjë me emërimin e një personi tjetër si Zëvendës Drejtor i Administratës për Standarde Profesionale në vend të parashtruesit të kërkesës, vendimi [Ref. nr. 07/01.-01A/8314]i 3 dhjetorit 2015.
43. Në aktgjykim, Gjykata Themelore arsyetoi se, *“paditësi, si i punësuar në institucion publik (siç është Ministria e Punëve të Brendshme), ai nga organi kompetent i Ministrisë nga data 15.03.2010 është caktuar në pozitën me përgjegjësinë dhe me vëllimin më të madh të punës, mirëpo ka realizuar pagë jo ekuivalente në raport me detyrat të cilat i ka kryer, duke pësuar kështu dëm material për shkak të keqadministrimit dhe neglizhencës të të paditurës, e cila edhe pse në organogramin e vetë ka paraparë pozitën përkatëse dhe mbi bazën e organogramit ka shpallur konkurs, por megjithëkëtë ka dështuar që të kërkojë miratimin paraprak nga MAP dhe në anën tjetër me marrjen e vendimit për caktimin e paditësit në të pozitat është krijuar pritja legjitime se pagesa duhet të bëhet konform detyrave dhe përgjegjësiive të punës.*

Gjykata rikujton se nuk ka qenë detyrë e paditësit ndërmarrja e veprimeve procedurale për aprovimin e pozitës së punës, pasi një obligim i tillë i takon ekskluzivisht punëdhënësit, e që në rastin konkret me dështimin e punëdhënësit për përmbushjen e detyrimeve ligjore lidhur me miratimin e pozitive të reja, nuk mund të mbahet përgjegjës paditësi dhe t'i mohohet e drejta për realizimin e pagës (këtu dallimit në pagë) si e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës. [...] Në mbështetje të dispozitës së nenit 79 të Ligjit për punë, lidhur me nenet 391, pika f, 393 dhe 142 të ligjit për procedurën kontestimore, meqë është gjetur se padia në pjesën për anulimin e vendimit të datës 03.12.2015, për caktimin e personit tjetër në pozitën e zëvendës drejtorit për standarde profesionale, është e pasafatshme pasi është parashtruar tre muaj pas nxjerrjes së vendimit, për këtë arsye gjykata vendosi si në paragrafin II të dispozitivit të aktgjykimit, duke e hedhur poshtë padinë si të palejuar”.

44. Më 24 mars 2017, Avokatura Shtetërore, e cila përfaqësonte Policinë e Kosovës në cilësi të palës së interesuar, parashtrroi ankesë për shkak të (i) shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe (iii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore, ashtu që të hidhet poshtë kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës si e palejueshme.
45. Më 27 mars 2017, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë edhe në Gjykatën e Apelit me pretendimin se aktgjykimi i lartpërmendur i gjykatës së shkallës së parë përmban shkelje të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu theksoi si bazë për ankesë se pika III (tre) e ankesës, ishte zbatimi i gabuar i së drejtës materiale në lidhje me afatin e kërkesëpadi së për diskriminim.
46. Më 15 maj 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi përgjigje në ankesën e Policisë së Kosovës të 24 marsit 2017.
47. Më 9 korrik 2020, Gjykata e Apelit me aktgjykimin [Ac. nr. 2046/17] e miratoi, si të bazuar, ankesën e Policisë së Kosovës, në atë mënyrë që në pikën (I) dhe (II) e ndryshoi aktgjykimin [C. nr. 3434/13] e Gjykatës Themelore, ashtu që refuzoi në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, ndërsa pika (III) e aktgjykimit të shkallës së parë ka mbetur e pandryshuar.
48. Në aktgjykim, Gjykata e Apelit arsyetoi se të ardhurat personale të parashtruesit të kërkesës ishin paguar, *"sipas rregullativës në fuqi të të paditurës dhe se në këtë drejtim nuk ka pasur diskriminim të tij, sa i përket pagës, në raport me pozitat që ka mbajtur dhe se fakti se e paditura a do të duhej apo jo të rregullonte çështjen e pagesës për pozita të caktuara për personelin e saj nuk mund të jetë objekt shqyrtimi apo interferimi në këtë çështje kontestimore, ngase çështja e tillë është në diskrecionin dhe autoritetin e të paditurës si punëdhënësi, ndaj dhe për këto arsye, kolegji ka gjetur se pretendimet ankimore të së paditurës përkitazi me mënyrën e vendosjes si në pikën I dhe II të diapozitivit të Aktgjykimit të atakuar janë krejtësisht të bazuara në gjendjen e fakteve dhe provave që përbën themelin faktik të çështjes objekt shqyrtimi, ndaj dhe për këtë është dashur që e njëjta të aprovohet në tërësi si e bazuar duke ndryshuar në tërësi zgjidhjen ligjore që është dhënë nga shkalla e parë në mënyrë që epilogu ligjor i çështjes të përlijet dhe të jetë në pajtim me themelin faktik të saj”.*
49. Më 22 shtator 2020, kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme për shkak të

shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

50. Më 22 prill 2021, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. nr. 584/2020 refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

51. Gjykata Supreme arsyetoi se,

“Pretendimet e paditësit se veprimet e të paditurës bien ndesh me dispozitat e nenit 35. paragrafi 1, të Ligjit nr. 03/L-212 të punës, ku është paraparë që i punësuari ka të drejtë në pagë që përcaktohet me kontratën e punës, duke u thirrur po ashtu në pretendimin se punonjësit e Policisë, lëvizjet e brendshme nuk i bëjnë me kontrata pune, por me autorizime që burojnë nga Ligji i Policisë nr. 03/L-035 nuk u mbështet me fakte konkrete, sepse në asnjë akt të lëshuar nga e paditura, nuk buron obligimi për pagesën shtesë përtej kushteve të konkursit e që nuk është e paraparë me kontratë ndërsa pagesa dhe ndryshimi midis gradave dhe vendeve të punës është çështje e brendshme e të paditurës që i nënshtrohet përveç Ligjit të Punës, edhe Ligjit të Policisë, konkretisht nenit 47, paragrafit 4, që parasheh se „Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të ministrit mund të përfshijë në buxhetin vjetor të policisë propozimin për shumat që nevojiten të përdoren për pagimin e gfarëdo pagese shtesë të autorizuar me ligj”. Pretendimi i paditësit lidhur me diskriminimin duke theksuar se raporti i të paditurës ndaj tij, është jo i drejtë dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Kundër Diskriminimit nuk u aprovuan. Me dispozitat e Ligjit Kundër Diskriminimit, parashihet se ky ligj zbatohet ndaj të gjitha veprimeve dhe mosveprimeve të personave fizikë dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, përfshirë edhe organet publike të cilat cenojnë të drejtat e personit fizik dhe juridik në fushat vijuese: si në aspektin e kushteve për qasje në punësim, vetëpunësim, kushtet e punësimit, kushtet e punës, shkarkimin nga puna, pagesën etj. Në rastin konkret ndryshimi dhe diferenca e pagës nuk mund të konsiderohen si pasojë e diskriminimit duke u trajtuar ndryshe nga të tjerët por si rezultat i të qenit zyrtar i graduar me grada major ose nënkolonel dhe sipas vendit të punës të përcaktuar me konkurs. Gjykata Supreme e Kosovës përkritazi me pretendimet e paditësit për vendimin e gjykatës së shkallës së parë me rastin e hedhjes së padisë së paditësit për pjesën që ka të bëjë me procedurën e zgjedhjes së zyrtarit policor, i zgjedhur në vendin e punës të cilin e ka mbuluar paditësi, konsideron se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar dhe drejtë ka zbatuar dispozitën e nenit 79 të Ligjit të Punës, duke pasur parasysh faktin se paditësi vendimin kontestues të paditurës e ka pranuar me datën 4 dhjetor 2015, ndërkohë që padinë e ka ushtruar me datë 3 mars 2016, rezulton s kanë kaluar të gjitha afatet ligjore sipas dispozitës së nenit 79 të Ligjit të Punës, i cili parasheh se „Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente”, sipas padisë së zgjeruar të paditësit, të ushtruar me datë 3 mars 2016, kjo është jashtë afatit ligjor”.

Komentet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit

52. Më 12 dhjetor 2022, Gjykata i dërgoi shkresë Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, duke u kërkuar që të paraqesin në Gjykatë komente dhe arsyeime në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se parashtrësia e tij (përgjigja ndaj ankesës së avokaturës shtetërore) e 15 majit 2017, asnjëherë nuk është marrë parasysh edhe pse është pranuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Përgjigja e Gjykatës së Apelit

53. Më 13 dhjetor 2022, Gjykata e Apelit ndaj kërkesës së Gjykatës paraqiti komentin si në vijim: *pas shikimit në shkresat e lëndës, të cilat mbesin në arkiv të kësaj gjykate nuk kishte asnjë përgjigje. Do të ishte mirë që kjo çështje të adresohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë.*

Përgjigja e Gjykatës Themelore

54. Më 17 janar 2023, Gjykata Themelore, me kërkesë të Gjykatës, në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe komentit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit pranoi komentin e mëposhtëm:
“ju njofton se kemi përgjigjen ndaj padisë C. nr. 3434/2013”, të cilin pala Ukë Salihu e ka dorëzuar në gjykatë më 15.05.2017, sipas regjistrit të gjykatës me datën 17.05.2017 i njëjti është dërguar në Gjykatën e Apelit. Si provë për këtë e bashkëngjirim fletëkthesën në origjinal, me vulën e pranimit nga Gjykata e Apelit”.
55. Më 18 janar 2023, Gjykata e Apelit përcolli komentin në vijim ndaj përgjigjes së Gjykatës Themelore: *“Ju njoftoj se përgjigjen në ankesë e kemi marrë pasi kemi marrë lëndën C. nr. 3434/2013, por për shkak të numrit të madh të shkresave të pranuar nga kjo gjykatë, kjo shkresë nuk i është bashkëngjitur rastit të vendosur nga kolegji i apelit me numër AC. Nr. 2046/2017, por këtu në këtë rast ka pasur dy ankesa si nga paditësi ashtu edhe nga i padituri”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

56. Parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat e rregullta, me vendimet e kontestuara, kanë shkelur nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
57. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës pretendon disa shkelje të dispozitave të Kushtetutës, duke arsyetuar secilën veç e veç, *“(i) Shkelja e së drejtës për një vendim të arsyetuar nga ana e Gjykatës së Apelit, (ii) Shkelja e së drejtës për një vendim të arsyetuar nga ana e Gjykatës Supreme, (iii) Shkelja e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit procedural nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme dhe (iv) shkeljen e parimit për „qasje në gjykatë“ si rezultat i zbatimit të ligjit të gabuar në lidhje me afatshmërinë nga ana e Gjykatës Themelore”.*
58. Përkitazi me shkeljen e së drejtës për vendim të arsyetuar nga Gjykata e Apelit, parashtruesi i kërkesës thekson si arsye kryesore, *“Gjykata e Apelit nuk precizoj rregullativën apo normën konkrete që lejon „diskrecionin e të paditurës” që të më përcaktoj pagë më të ulët se sa paga e gradës që ka paraparë PK me aktet që ka nxjerrë vet dhe mbi bazën e të cilave e ka shpallur edhe konkursin, apo që lejon diskrecionin që për të njëjtën pozitë, punonjësit tjetër t'i caktohet pagë prej [...] në muaj më e lartë se paga ime, për të mbështetur konstatimin e saj se nuk ka diskriminim ndaj meje, sa i përket pagës.”*
59. Lidhur me shkeljen e të drejtës për vendim të arsyetuar nga Gjykata Supreme, parashtruesi i kërkesës përmend si arsye kryesore, *“Gjykata Supreme nuk arriti të adresojë në mënyrë adekuate e as të jap arsye të mjaftueshme se përse si shkak i dështimit të PK-së për të kërkuar aprovimin paraprak të pagës adekuate për pozitën e shpallur me konkurs, është dashur të paguhem me pagën një pozite tjetër (zyrtar i lartë ligjor) për të cilën nuk është shpallur konkurs e as nuk kam konkurruar, përkatësisht, meqë ka rezultuar se për të dy pozitave veç se k qenë e aprovuar grada*

(major), përse është dashur që të paguhem me pagën që nuk i përgjigjet gradës, dhe si rrjedhojë, cilat janë arsyet se nuk më takon kompensimi i diferencës në pagë sipas gradës, për të cilat kam qenë i ngarkuar me detyrat dhe përgjegjësitë e punës. Për më tepër, nuk morra përgjigje se si është e mundur që të mos më takoj kompensimi proporcional me pagën e kolegut të punës, përderisa është vërtetuar se „për të njëjtin titull të pozitës në të njëjtat kushte dhe rrethana të punës, unë jam paguar me pagë 390,25 € më të ulët nga i njëjti punëdhënës“. Mostrajtimi i këtyre fakteve relevante, në rastin tim, provon më së miri mungesën e vlerësimit objektiv dhe mungesën e arsytimit të aktgjyqimit. [...] Gjykata Supreme, në aktgjykimin e saj jo vetëm që nuk adresoi me korrektesë dhe nuk dha përgjigje në pretendimet e mia thelbësore, por nuk tregoi as qartësi të mjaftueshme lidhur me faktet dhe arsyet në të cilat e bazoj vendimin e saj, duke dhënë edhe konkluzione arbitrare dhe si rezultat i kësaj konsideroj se me këtë vendim më është shkelur drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së”.

60. Lidhur me shkeljen e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit procedural nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, parashtruesi i kërkesës pretendon, “Gjykata e Apelit përveç se nuk ka ofruar arsyetimin e duhur për të justifikuar aktgjykimin e saj, duke shkalur të drejtën për një vendim të arsyetuar, qartazi shihet se arsyetimin e ka bazuar vetëm në thëniet e PK-së të adresuara në ankesë, pa u siguruar nëse këtyre thëniet unë u jam kundërpërgjigjur nëpërmjet ushtrimit të përgjigjes kundër ankesës së palës kundërshtare, të cilën e kam dorëzuar në gjykatë më datë 15 maj 2017. Mirëpo, përgjigja ime jo vetëm që nuk është shqyrtuar fare, por në gjithë aktgjykimin e Gjykatës së Apelit as që përmendet që unë kam paraqitur përgjigje në ankesën e PK-së dhe kjo jo vetëm që paraqet shkelje të parimit të barazisë së palëve, por paraqet edhe një sjellje arbitrare nga ana e gjykatës. Sikur Gjykata e Apelit t’i shqyrtonte pretendimet e mia të paraqitura në përgjigjen në ankesë dhe po t’i shqyrtonte faktet që u jam referuar, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, me siguri se vendimi i saj do të ishte në një linjë me vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. [...]Gjykata Supreme, si instanca më e lartë e gjyqësorit të rregullt që në parim është kontrolli i zbatimit të ligjit material dhe procedural nga gjykatat e shkallë më të ulët gjyqësore, po ashtu shihet se nuk e ka shqyrtuar fare këtë pretendim. Ka qenë detyrim i gjykatave, që jo vetëm të më njoftojnë me kopjen e ankesës së palës kundërshtare dhe të pranojnë përgjigjen time në ankesë, sa për të përmbushur një hap procedural, por ka qenë obligim fillimisht i Gjykatës së Apelit ta trajtojë posaçërisht dhe të ndërhyjë për ta riparuar këtë të metë procedurale të pakapërcyeshme e cila është në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit procedural, duke më privuar nga e drejta për një proces të rregullt gjyqësor”.
61. Përkitazi me “diskriminimin” dhe shkeljen e parimit të “qasjes në gjykatë” parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme janë bazuar në ligjin e gabuar, përkatësisht, sa i përket afatit për ankesa në lidhje me diskriminim, gjykatat është dashur të mbështeten në Ligjin e Punës dhe në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
62. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që,
 “I. TË SHPALL kërkesën të pranueshme;
 II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës;

- III. TA SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 584/2020 të 22 prillit 2021, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 2046/17 të 9 korrikut 2020 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore C. nr. 3434/13 të 28 shkurtit 2017 për pikën III (tre) të dispozitivit;
- IV. TA KTHEJË Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 584/2020 të 22 prillit 2021 për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese“.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

[...]

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

[...]

Neni 54

[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga

gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

(...)

[...]

LIGJI NR. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 5

5.1 Gjykata do t'i jep mundësi secilës palë që të deklarohet rreth kërkesave dhe thënieve të palës kundërshtare.

5.2 Vetëm në rastet e përcaktuara me këtë ligj gjykata ka drejtë që të vendos mbi kërkesën për të cilën palës kundërshtare nuk i është dhënë mundësia që të deklarohet.

[...]

Procedura sipas ankesës

Neni 185

Ankesa i paraqitet gjykatës e cila e ka dhënë aktgjykimin e shkallës së parë, në një numër të mjaftueshëm ekzemplarësh për gjykatën dhe palën kundërshtare.

[...]

Neni 187

187.1 Një ekzemplar të ankesës së paraqitur me kohë, të lejueshme dhe të plotë, gjykata e shkallës së parë ia dërgon palës kundërshtare, e cila mundet, brenda afatit prej shtatë ditësh, të paraqesë po në këtë gjykatë përgjigje në ankese.

187.2 Një ekzemplar të përgjigjes në ankese gjykata e shkallës së parë ia dërgon ankuesit menjëherë, ose më së voni brenda afatit shtatë ditë nga arritja e saj në gjykatë.

187.3 Përgjigja në ankese e paraqitur pas afatit nuk do të merret në shqyrtim nga gjykata e shkallës së dytë.

187.4 Parashtrësit që mbërrijnë në gjykatë pas arritjes së përgjegjës në ankese, apo pas skadimit të afatit për përgjigje në ankese nuk do të merren në shqyrtim, përpos kur gjykata nga pala shprehimisht kërkon deklarata plotësuese.

Neni 188

188.1 Pas pranimit të përgjigjes në ankese, apo pas skadimit të afatit për përgjigje në ankese, gjykata e shkallës së parë ankuesin dhe përgjigjen në ankese, nëse është paraqitur me të gjitha shkresat e lëndës ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë në afat prej shtatë ditësh më së shumti.

188.2 Po që se ankuesi pretendon se në procedurën e shkallës së parë janë shkelur dispozitat e procedurës kontestimore, gjykata e shkallës së parë mund të jep shpjegime lidhur me thëniet në ankese që i përkasin shkeljeve të tilla, e sipas nevojës mund të bëjë hetime me qëllim të verifikimit të saktësisë së thënieve përkatëse në ankese.

Neni 189

189.1 Pasi të arrijë në gjykatën e shkallës së dytë dosja e lëndës, gjyqtari relator e përgatitë raportin me qëllim të shqyrtimit të lëndës në gjykatën e ankimit, e cila gjykon me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtar.

189.2 Gjyqtari relator, po që nevoja, nga gjykata e shkallës së parë mund të kërkojë raport për shkeljet e dispozitave procedurale dhe mungesat tjera të përmendura në ankesë, si dhe të kërkojë që, me qëllim të konstatimit të shkeljeve, përkatësisht mungesave të tilla, të bëhen hetimet e duhura.

LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS i 1 nëntorit 2010

[...]

KREU IX

Procedurat për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës

Neni 78

Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit

- 1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura.*
- 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës.*
- 3. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh.*

Neni 79

Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë

Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.

[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

- 63. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.*
- 64. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:*

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

65. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në nenet 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

*Neni 47
(Kërkesa individuale)*

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

*Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)*

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

*Neni 49
(Afatet)*

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

66. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 584/2020] e Gjykatës Supreme të 22 prillit 2021 pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
67. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe se e njëjta nuk mund të deklarohet e papranueshme në bazë të kushteve të përcaktuara në paragrafin (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, dhe për këtë arsye duhet ta deklarojë atë të pranueshme dhe të shqyrtojë meritat e saj.

Meritat e kërkesës

68. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston aktgjykimin [Rev. nr. 584/2020] të 22 prillit 2021 të Gjykatës Supreme, përmes të cilit është refuzuar si e pabazuar kërkesa e parashtruesit për revizion ndaj aktgjykimit [Ac. nr. 2046/17] të 9 korrikut 2020 të Gjykatës së Apelit, përmes të cilit është aprovuar si e bazuar ankesa e Policisë

së Kosovës dhe është ndryshuar aktgjykimi [C. nr. 3434/13] i Gjykatës Themelore i 28 shkurtit 2017.

69. Gjykata rikujton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i referohet kontestit të punës të parashtruesit të kërkesës kundër Policisë së Kosovës lidhur me diferencën në pagë konkretisht sipas vendimeve [PK nr. Ref. PK/DP/AP/2244] të 12 marsit 2010 dhe [Ref. Nr. 07/1-01A18314] të 3 dhjetorit 2015, të Policisë së Kosovës, siç u citua më lart. Lidhur me këtë, duke vepruar sipas kërkesës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore fillimisht e pranoi pjesërisht kërkesën e parashtruesit dhe atë vetëm sa i përket vendimit [të PK-së nr. Ref. PK/DP/AP/2244] të 12.03.2010, ndërsa refuzoi kërkesën lidhur me vendimin [Ref. nr. 07/1-01A18314] të 03.12.2015, për shkak të papranueshmërisë.
70. Pas kësaj, parashtruesi i kërkesës dhe Policia e Kosovës parashtruan ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë në Gjykatën e Apelit, dhe parashtruesi i kërkesës gjithashtu parashtroi përgjigje në ankesën e Policisë së Kosovës brenda afatit ligjor. Gjykata e Apelit, duke vendosur lidhur me ankesat e të dyja palëve, aprovoi ankesën e Policisë së Kosovës dhe ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë në atë mënyrë që është refuzuar tërësisht si e pabazuar kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës, ndërsa përgjigja në ankesën e parashtruesit të kërkesës nuk është marrë në shqyrtim.
71. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit.
72. Parashtruesi i kërkesës pretendon në Gjykatën Kushtetuese se (i) Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë shkelur parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit procedural, (ii) Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme përmes aktgjyqimeve të tyre i mohuan parashtruesit të kërkesës të drejtën për një vendim gjyqësor të arsyetuar, dhe (iii) Gjykata Themelore ka shkelur parimin e qasjes në gjykatë duke zbatuar gabimisht ligjin, përkatësisht afatin për paraqitjen e ankesës.
73. Për arsyet e lartpërmendura, parashtruesi i kërkesës thekson se gjykatat e rregullta kanë shkelur dispozitat e procedurës dhe nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nenin 32 dhe nenin 54 të Kushtetutës, përkatësisht *“elementet thelbësore të termiit “gjykim i drejtë” [...] (i) të drejtën për një vendim të arsyetuar; (ii) parimin e “barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit procedural”; dhe (iii) zbatimin e gabuar të ligjit”*.
74. Prandaj, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për (i) shkeljen e parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, duke vazhduar më pas me pretendimin për (ii) vendimin e paarsyetuar dhe (iii) zbatimin e gabuar të ligjit. Gjykata do të bazohet në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në pajtim me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e obliguar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

I. PRETENDIMET LIDHUR ME PARIMIN E KONTRADIKTORITETIT DHE BARAZISË SË ARMËVE

75. Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendimin e tij për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit e ndërlihdë me mosshqyrtimin nga ana e Gjykatës së Apelit të përgjigjes në ankesë (të 15 majit 2017) të palës së dytë, përkatësisht Policisë së Kosovës.

76. Rrjedhimisht, në dritën e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme të zhvilluara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së përkritazi me parimin e kontradiktoritetit dhe atë të barazisë së armëve.
77. Në fund, Gjykata gjatë shqyrtimit dhe elaborimit të parimeve të përgjithshme të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së përkritazi me parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve do të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse rastet e GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, të përmendura nga parashtruesi në kërkesën e tij i referohen rrethanave të ngjashme faktike dhe juridike si ato në rastin e tij dhe po ashtu do të vlerësojë nëse këto raste janë të aplikueshme në rastin e tij.

i) Parimet e përgjithshme në lidhje kontradiktoritetin dhe barazinë e armëve

78. Gjykata fillimisht sqaron se parimi i “barazisë së armëve” është element i një koncepti më të gjerë të një gjykimi të drejtë që kërkon “ekuilibër të drejtë midis palëve” ku secilës palë i jepet mundësi e arsyeshme të paraqes rastin e tij/saj nën kushtet që nuk do të vendosnin atë në disavantazh substancial *vis-a-vis* palës kundërshtare. (shih rastin e GJEDNJ [Yvon kundër Francës](#), nr. 44962/98, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 31, dhe rastin e GJEDNJ-së [Dombo Beheer B.V. kundër Holandës](#), nr. 14440/88, Aktgjykimi i 27 tetorit 1993, paragrafi 33; shih *mutatis mutandis*, po ashtu rastin e Gjykatës [KI31/17](#), parashtrues *Shefqet Berisha*, Aktgjykim i 30 majit 2017, paragrafi 70).
79. Parimi i kontradiktoritetit procedural në anën tjetër, nënkupton që palët në procedurë duhet të kenë dijeni dhe mundësi të komentojnë dhe kundërshtojnë pretendimet dhe provat që paraqiten gjatë shqyrtimit gjyqësor (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, [Brandstetter kundër Austrisë](#), nr. 11170/84, Aktgjykimi i 29 gushtit 1991; [Vermeulen kundër Belgjikës](#), nr. 19075/91, Aktgjykimi i 20 shkurtit 1996, [KI193/19](#), parashtrues *Salih Mekaj*, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2020, paragrafi 47).
80. Duke u referuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata potencon se parimi i barazisë së armëve dhe parimi i kontradiktoritetit procedural janë të lidhur ngushtë dhe në shumë raste GJEDNJ i ka trajtuar së bashku (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Jasper kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 27052/95, Aktgjykimi i 16 shkurtit 2000; [Zahirović kundër Kroacisë](#), nr. 58590/, Aktgjykimi i 25 korrikut 2013 [KI193/19](#), parashtrues *Salih Mekaj*, cituar më lart, paragrafi 48, dhe rasti i Gjykatës [KI 84 21](#) parashtrues *Telekomi i Kosovës*, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2021, paragrafi 102).
81. Kërkesa e “barazisë së armëve”, në kuptimin e një “ekuilibri të drejtë” midis palëve, vlen në parim për raste civile si dhe për raste penale (shih rastin e Gjykatës [KI10/14](#), parashtrues, *Shoqëria aksionare Raiffeisen Bank Kosovë SH. A.*, Aktgjykim i 20 majit 2014, paragrafi 42; dhe rastin e Gjykatës [KI31/17](#), parashtrues *Shefqet Berisha* cituar më lart, paragrafi 71).
82. GJEDNJ ka theksuar se sipas parimit të “barazisë së armëve”, është e papranueshme që një palë në procedurë të paraqesë vërejtje apo komente para gjykatave të rregullta, të cilat kanë për qëllim që të ndikojnë në vendimmarrjen e gjykatës, pa dijeninë e palës tjetër dhe pa i dhënë mundësi palës tjetër të përgjigjet në to. I takon palës së përfshirë në procedurë pastaj të vlerësojë nëse vërejtjet apo komentet e paraqitura nga pala tjetër meritojnë reagim. (shih rastin e GJEDNJ [APEH Üldözötteinek Szövetsége dhe të tjerët kundër Hungarisë](#), Aktgjykim i 5 janarit 2011, paragrafi 42).
83. Andaj, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, parimi i “barazisë së armëve” cenohet kur ankesa e palës kundërshtare nuk i është komunikuar parashtruesit të kërkesës dhe

ai nuk është informuar për një ankesë të tillë përmes ndonjë mënyre tjetër. (shih rastin e GJEDNJ [Beer kundër Austrisë](#), nr. 30428/96, Aktgjykim i 6 shkurtit 2001, paragrafi 19, shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së [Andersena kundër Letonisë](#), Aktgjykim i 19 shtatorit 2019, paragrafi 87). Ngjashëm, GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të këtij parimi në rast kur vetëm një nga dy dëshmitarët kyç është lejuar që të dëshmojë (shih rastin [Dombo Beheer B.V. kundër Holandës](#), cituar më lartë, paragrafët 34 dhe 35).

84. GJEDNJ po ashtu kishte konstatuar shkelje të parimit të “barazisë së armëve” për shkak të pozicionit të prokurorit të përgjithshëm në procedurën para Gjykatës së revizionit, që për dallim nga palët në procedurë, prokurori i përgjithshëm ishte i pranishëm në seancë, ishte i informuar paraprakisht për pikëpamjen e gjyqtarit raportues, merrte pjesë plotësisht në debate dhe kishte mundësinë të shprehte me gojë pikëpamjen e tij pa u kundërshtuar nga palët ndërgjyqëse, dhe kjo mungesë ekuilibri theksohej nga fakti se seanca nuk ishte publike. Kjo për GJEDNJ-në kishte ngritur çështjen e mos-balancës në mes të palëve në procedurë. (shih rastin e GJEDNJ [Martinie kundër Francës](#), Aktgjykim i 12 prillit 2006, paragrafi 50).
85. GJEDNJ kishte gjetur shkelje të parimit të “barazisë së armëve” edhe në rastin *Yvon kundër Francës* kur komisionari i Qeverisë, merrte pjesë në procedurë gjyqësore për përcaktimin e shumës së shpronësimit, së bashku me autoritetin e shpronësimit kundër palës tjetër prona e të cilit ishte subjekt shpronësimi. GJEDNJ kishte konstatuar në këtë rast se pala e shpronësuar ishte ballafaquar jo vetëm me autoritetin e shpronësimit por edhe me komisionarin e Qeverisë, ku këta të fundit kanë pasur përparësi të dukshme për qasje në dokumente në raport me palën e shpronësuar. Për më tepër, komisionari i Qeverisë, që ishte edhe ekspert edhe palë në procedurë, kishte qenë në pozicion dominues dhe kishte mundësi për të ushtruar një ndikim të madh në vlerësimin e gjyqtarit. Kjo për GJEDNJ-në kishte ngritur çështjen e mos-balancës *vis a vis* palës së shpronësuar që ishte e papajtueshme me parimin e “barazisë së armëve”. (shih rastin e GJEDNJ [Yvon kundër Francës](#), Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 37).
86. GJEDNJ në rastin *De Haes dhe Gijssels kundër Belgjikës* kishte konstatuar shkelje të parimit të “barazisë së armëve” kur pala kundërshtare ka qenë në një pozicion ose funksion që e ka favorizuar atë *vis a vis* palës tjetër, për shkak të mundësisë që vetëm njëra palë të ketë qasje në dokumentet relevante e të cilat ndërlidheshin me rastin konkret. Pra në rastin *De Haes and Gijssels kundër Belgjikës*, dy gazetarë të revistës Humo, ishin gjobitur nga një gjykatë civile pasi në disa artikuj të publikuar, gazetarët kishin akuzuar disa gjyqtarë se ata kanë qenë të anshëm në një rast kur ata kishin vendosur që kujdesi lidhur me fëmijët e një çifti t’i takonte njërit prind. Në paditë e tyre kundër gazetarëve, gjyqtarët ishin referuar edhe në dosjen e rastit lidhur me kujdestarinë e fëmijës të cilën ata vet e kishin trajtuar, por dokumentet në dosje nuk ishin të qasshme për gazetarët. Andaj, gazetarët ishin ankuar para GJEDNJ-së, mes tjerash për shkelje të parimit të “barazisë së armëve” me pretendimin se artikujt e publikuar ishin të bazuar në dokumente të cilat ishin të qasshme për gjyqtarët por që gjykatat e rregullta të Belgjikës, përkundër kërkesës së gazetarëve, nuk u kishin lejuar atyre qasje në to, sidomos në opinionin e tre (3) profesorëve, me çka gazetarët do të dëshmonin pretendimet e tyre se në fakt gjyqtarët ishin të anshëm dhe nuk e kishin trajtuar rastin lidhur me kujdestarinë e fëmijës në mënyrën e duhur. GJEDNJ, duke marrë parasysh pretendimet e parashtruesve të kërkesës që kishin kërkuar nga gjykatat belge qasje në opinionin e tre (3) profesorëve, erdhi në përfundim se gjykata belge duke refuzuar kërkesën e gazetarëve për qasje në dosjen në të cilën kishin vendosur gjyqtarët në fjalë kishte vendosur gazetarët në pozitë substancialisht të disfavourshme *vis a vis*, palës tjetër, në këtë rast gjyqtarëve në cilësi të tyre si paditës. Për këto arsye GJEDNJ kishte gjetur shkelje të parimit të barazisë së armëve të

garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së. (shih rastin e GJEDNJ [Haes dhe Gijssels kundër Belgjikës](#) , Aktgjykim i 24 shkurtit 1997, paragrafët 54 deri 58).

87. Megjithatë, GJEDNJ ka theksuar e drejta e palëve lidhur me të drejtën për një gjykim të drejtë duke përfshirë edhe parimin e “barazisë së armëve” nuk është absolute. Shtetet gëzojnë një margjinë të caktuar të vlerësimit në këtë aspekt. Por, i takon GJEDNJ-së që të vendos në instancë të fundit nëse këto parime respektohen (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ [Regner kundër Republikës Çeke](#) , Aktgjykim i 19 shtatorit 2017, paragrafi 147).
88. Në këtë aspekt, GJEDNJ, përmes praktikës së saj ka përcaktuar që një parregullsi në proces, në disa kushte, mund të korrigojë në një fazë të mëvonshme ose në nivelin e njëjtë (shih rastin e GJEDNJ-së [Helle kundër Finlandës](#), Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 54) ose, nga një gjykatë më e lartë (shih rastet e GJEDNJ-së, [Schuler-Zraggen kundër Zvicrës](#) , Aktgjykim i 24 qershorit 1993, paragrafi 52; dhe, e kundërta , [Albert et Le Compte kundër Belgjikës](#), Aktgjykim i 10 shkurtit 1983, paragrafi 36; si dhe [Feldbrugge kundër Holandës](#), Aktgjykim i 29 majit 1986, paragrafët 45-46).
89. Në rastin [Helle kundër Finlandës](#), z. Helle kishte argumentuar në parashtresën e tij se ai ishte vendosur në disavantazh për faktin se Trupës Katedrale (Cathedral Chapter) iu kërkuar në dy raste nga Gjykata e Lartë Administrative për të dhënë mendimin e saj mbi bazueshmërinë e ankesave të tij. GJEDNJ, theksoi se nuk pajtohet me pohimin e z. Helle sepse çdo paragjykim i mundshëm që mund të ishte shkaktuar për rezultatin e ankesës së tij u kompensua nga fakti që atij iu dha një mundësi e mirëfilltë nga Gjykata e Lartë Administrative për të paraqitur komentet e tij mbi përmbajtjen e mendimeve të Trupës Katedrale. Z. Helle e shfrytëzoi këtë mundësi në dy raste dhe në këto rrethana GJEDNJ gjeti se z. Helle nuk mund të pohojë se kishte shkelje të kërkesës së “barazisë së armëve” të qenësishme në konceptin e një procedure të drejtë (shih rastin e GJEDNJ-së, [Helle kundër Finlandës](#), Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 54).
90. Në rastin [Schuler-Zraggen kundër Zvicrës](#), GJEDNJ gjeti se procedurat para Bordit të Apelimit nuk i mundësuan znj. Schuler-Zraggen të kishte një pamje të plotë dhe të hollësishme të funksioneve të dhëna Bordit. Megjithatë, GJEDNJ konsideroi që Gjykata Federale e Sigurimeve e rregulloi këtë mangësi duke kërkuar nga Bordi të vinte në dispozicion të parashtruesit të kërkesës të gjitha dokumentet - i cili ishte në gjendje, ndër të tjera, të bënte kopje - dhe më pas t’ia përcillte dosjen avokatit të parashtruesit të kërkesës. Rrjedhimisht GJEDNJ, konstatoi se meqenëse, marrë në tërësi, procedurat e kontestuara ishin të drejta, nuk ka pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së në këtë drejtim (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Schuler-Zraggen kundër Zvicrës](#) , Aktgjykim i 24 qershorit 1993, paragrafi 52).
91. Për dallim, në rastin [Albert et Le Compte kundër Belgjikës](#), GJEDNJ gjeti shkelje të nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së, për arsye se karakteri publik i procedurave të kasacionit nuk mjafton për të rregulluar mangësinë që ishte konstatuar se ekziston në fazën e procedurës disiplinore. Gjykata e Kasacionit nuk merr parasysh trajtimin e meritave të rastit, që do të thotë se shumë aspekte të “kontesteve” në lidhje me “*të drejtat dhe detyrimet civile*”, duke përfshirë shqyrtimin e fakteve dhe vlerësimin e proporcionalitetit midis fajit dhe sanksionit, bien jashtë juridiksionit të saj (shih rastin e GJEDNJ-së, [Albert et Le Compte kundër Belgjikës](#), Aktgjykim i 10 shkurtit 1983, paragrafi 36). Në rastin [Feldbrugge kundër Holandës](#), GJEDNJ gjeti shkelje për faktin se znj. Feldbrugge nuk kishte kushtet për qasjen në dy Bordet përkatëse me çka ajo nuk mundi të kontestojë meritat e vendimit të Presidentit të Bordit të Apelimit. Rrjedhimisht, mangësia e gjetur në këtë aspekt të procedurës para zyrtarit gjyqësor

nuk mund të rregullohej në stad të mëvonshëm (shih rastin e GJEDNJ-së, *Feldbrugge kundër Holandës*, Aktgjykim i 29 majit 1986, paragrafët 45-46).

92. Rrjedhimisht, GJEDNJ ka konstatuar në praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore se mangësitë në shkallë të parë mund të përmirësohen përmes institucionit të ankesës, me kusht që institucioni që vendos për ankesë të ketë “juridiksion të plotë”. Sipas GJEDNJ-së, ankesa ka të bëjë me pretendimin për mos-komunikim të dokumentit, koncepti i “juridiksionit të plotë” nënkupton që gjykata që e shqyrton ankesën jo vetëm që duhet të ketë të drejtë të vlerësoj ankesën, por po ashtu duhet të ketë kompetencë që të prish vendimin në fjalë dhe ose të merr vendimin vet apo të kthej rastin për një vendim të ri nga një kolegji i pavarur (Shih rastet e GJEDNJ-së, *M.S. kundër Finlandës*, Aktgjykim i 22 qershorit 2005, paragrafi 35; *Köksöy kundër Turqisë*, Aktgjykim i 13 janarit 2021, paragrafi 36; *Bacaksız kundër Turqisë* Aktgjykim i 10 dhjetorit 2019, paragrafi 59).

a. Aplikimi i këtyre parimeve në rastin e parashtruesit të kërkesës

93. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin e tij nuk është respektuar “parimi i kontradiktoritetit” dhe “barazia e armëve” për arsye se nuk është marrë parasysh dhe nuk është shqyrtuar përgjigja e tij (e 15 majit 2017) ndaj Policisë së Kosovës nga Gjykata e Apelit.

94. Lidhur me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se ka kërkuar informata nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit, në lidhje me parashtruesin, përkatësisht përgjigjen ndaj ankesës së parashtruesit të kërkesës.

95. Në përgjigjen e dorëzuar në Gjykatë më 17 janar 2023, Gjykata Themelore theksoi si në vijim:

“ju njofton se kemi përgjigjen ndaj padisë C. nr. 3434/2013”, të cilin pala Ukë Salihu e ka dorëzuar në gjykatë më 15.05.2017, sipas regjistrimit të gjykatës me datën 17.05.2017 e njëjt është dërguar në Gjykatën e Apelit dhe paraqesim provë për këtë fletëkthesën në origjinal, me vulën e pranimit nga Gjykata e Apelit”.

96. Gjykata e Apelit, në përgjigjen e dorëzuar në Gjykatë më 18 janar 2023, theksoi si më poshtë:

“Ju njoftoj se përgjigjen në ankesë e kemi marrë pasi kemi marrë lëndën C. nr. 3434/2013, por për shkak të numrit të madh të shkresave të pranuar nga kjo gjykatë, kjo shkresë nuk i është bashkëngjitur rastit të vendosur nga kolegji i apelit me numër AC. Nr. 2046/2017, por këtu në këtë rast ka pasur dy ankesa si nga paditësi ashtu edhe nga i padituri”.

97. Gjykata thekson më tej (i) paragrafin 1, të nenit 187; dhe (ii) paragrafin 2, të nenit 187 të Ligjit për procedurën kontestimore, të cilët përcaktojnë:

187.1 Një ekzemplar të ankesës së paraqitur me kohë, të lejueshme dhe të plotë, gjykata e shkallës së parë ia dërgon palës kundërshtare, e cila mundet, brenda afatit prej shtatë ditësh, të paraqesë po në këtë gjykatë përgjigje në ankesë.

187.2 Një ekzemplar të përgjigjes në ankesë gjykata e shkallës së parë ia dërgon ankuesit menjëherë, ose më së voni brenda afatit shtatë ditor nga arritja e saj në gjykatë.

98. Së pari, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit në përgjigjen e dhënë më 18 janar 2023, deklaroi se ka pranuar përgjigje në ankesën e parashtruesit të kërkesës. por për shkak të numrit të madh të parashtrësive në atë gjykatë, nuk i është dorëzuar kolegjit i cili ka vendosur lidhur me këtë çështje. Përkundër përgjigjes së dhënë, Gjykata vëren se ekzistonte një detyrim ligjor që përgjigja në ankesën e parashtruesit të kërkesës t'i dërgohej edhe palës së kundërt dhe të shqyrtohej nga gjykata, që rrjedh nga dispozitat e lartcekura të Ligjit për Procedurën Kontestimore.
99. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit me rastin e vendimmarrjes së saj me aktgjykimin Ac. nr. 2046/17 duke mos shqyrtuar argumentet e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht përgjigjen ndaj ankesës së Policisë së Kosovës, si dhe dokumentet tjera të bashkangjitura. në përgjigjen ndaj ankesës ka vepruar në mënyrë joadekuate, duke marrë parasysh praktikën e saj gjyqësore dhe praktikën e GJEDNJ-së dhe, si dhe dispozitat ligjore të LPK-së, konkretisht, paragrafi 1, neni 187 dhe paragrafi 2, neni 187, i cili parashikon paraqitjen e një përgjigjeje ndaj ankesës.
100. Në këtë aspekt, sipas parimeve të shpjeguara në detaje më sipër, të vendosura nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe GJEDNJ-së, por edhe sipas legjislacionit në fuqi, gjykatat e rregullta (i) duhet t'u japin mundësi palëve si dhe (ii) duhet të bëjnë shqyrtim të mirëfilltë të parashtrësive, të argumenteve dhe të provave të paraqitura nga palët dhe të vlerësojnë, pa paragjykim, nëse ato janë të rëndësishme dhe me peshë për vendimin e saj.
101. Megjithatë Gjykata gjithashtu vëren se pas pranimit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur revizion në Gjykatën Supreme duke theksuar ndër të tjera çështjen e mostrajtimit të përgjigjes së parashtruesit ndaj ankesës së Policisë së Kosovës, lidhur me të cilën parashtruesit nuk i ishte dhënë mundësia që këto pretendime të trajtohen nga Gjykata e Apelit, pasi Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit fare nuk ka potencuar faktin që parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur përgjigje ndaj ankesës së Policisë së Kosovës.
102. Parashtruesi i kërkesës në revizionin e parashtruar në Gjykatën Supreme, ndër të tjera theksoi *“Duke u mbështetur në njërën anë në gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e shkallës së dytë në anën tjetër ka ndryshuar aktgjykimin [...] përderisa nuk përmend asnjë provë konkrete të të paditurës që ka patur rëndësi vendimtare për të ndryshuar zgjidhjen e çështjes. Thëniet dhe pretendimeve të të paditurës në ankesë, paditësi u është kundërpërgjigjur po me këto fakte dhe prova në përgjigjen e dhënë ndaj ankesës, me të cilat siç shihet gjykata nuk i ka ballafaquar fare me pretendimet e të paditurës apo me provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, a as që i ka përmendur në aktgjykim”*.
103. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u mbështetur në praktikën e GJEDNJ-së, po ashtu rikujton se mangësitë në shkallën e parë, mund të rregullohen në shkallën e dytë (apel ose revizion), nëse institucioni i apelit ka “juridiksion të plotë” lidhur me çështjen. Lidhur me këtë Gjykata përsërit se kur një ankesë është bërë lidhur me moskomunikimin e dokumenteve, koncepti i “juridiksionit të plotë” përfshinë jo vetëm faktin që gjykata e apelit ka të drejtë të shqyrtojë ankesën, por gjithashtu nëse e njëjta ka kompetencë për të prishur vendimin e kontestuar dhe/ose të marrë vendim vet lidhur me çështjen ose ta kthejë çështjen për vendim të ri nga një organ i paanshëm (shih *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së, [Köksöy kundër Turqisë](#), cituar më lart, paragrafi 36; rastin [M.S. kundër Finlandës](#), cituar më lart, paragrafi 35)
104. Në rastin *Köksöy kundër Turqisë*, GJEDNJ theksoi se fakti që nuk u ishte komunikuar parashtrësve të kërkesës lidhur me provat e marra nga Gjykata e Kasacionit më vetëinitiativë ngre një problem. Me rastin e apelit Gjykata e Kasacionit prishi

vendimin e gjykatës së shkallës së parë, dhe i ktheu të njëjtës rastin për ri-shqyrtim. Parashtruesit në këtë rast nuk pretenduan që dokumentet dhe informacioni në fjalë mbështetur nga Gjykata e Kasacionit nuk ishte i disponueshëm për ta pasi ata mësuan për përmbajtjen e tyre në vendimin e Gjykatës së Kasacionit. Ankesa e tyre në këtë drejtim është kufizuar në faktin se pikëpamjet e tyre nuk ishin kërkuar nga Gjykata e Kasacionit para vendimit të saj lidhur me ankesën. GJEDNJ, theksoi se në procedurën e ri-kthimit të rastit, gjë që dallon nga rasti i tanishëm pasi i njëjti nuk është rikthyer në rishqyrtim, ankuesit kishin mundësi për të ngritur kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të Gjykatës së Kasacionit. GJEDNJ konstatoi se efektet e mangësisë procedurale në procedurat e apelit ishin korrigjuar në fazën e ri-kthimit për atë kohë sa parashtruesit e kërkesës ishin në gjendje të kishin njohuri për dokumentet dhe informacionet në fjalë pasi që rasti i tyre është rikthyer për rishqyrtim dhe tutje nga fakti që ankuesit ishin në gjendje t'u përgjigjeshin atyre para trupit gjykues përgjatë seancës. Rrjedhimisht, GJEDNJ konstatoi se nuk ka shkelje të nenit 6 paragrafi 1 sepse mangësia procedurale gjatë shqyrtimit të ankesës në Gjykatën e Kasacionit nuk ndikoi në parimin e kontradiktoritetit në masë të tillë që t'i bëjë procedurat në tërësi të padrejta (Shih rastin e GJEDNJ, [Köksoy kundër Turqisë](#) , cituar më lart, paragrafët 37-39).

105. Andaj, në vazhdim Gjykata bazuar edhe në praktikën e GJEDNJ-së, do të vlerësojë nëse gjykata që shqyrton ankesën, në këtë rast Gjykata e Apelit, kishte juridiksion të plotë lidhur me rastin, konkretisht, nëse kishte mundësinë për të prishur vendimin e kontestuar, ose të marrë vendim vet lidhur me çështjen ose ta kthejë çështjen për vendim të ri nga një organ i paanshëm, si dhe të vendosë për të gjitha çështjet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës në përgjigjen ndaj ankesës së Policisë.
106. Në këtë rast, neni 187 i LPK-së parasheh që një ekzemplar të ankesës së paraqitur me kohë, të lejueshme dhe të plotë, gjykata e shkallës së parë ia dërgon palës kundërshtare, e cila mundet, brenda afatit prej shtatë ditësh, të paraqesë po në këtë gjykatë përgjigje në ankesë, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni parasheh që një ekzemplar të përgjigjes në ankesë gjykata e shkallës së parë ia dërgon ankuesit menjëherë, ose më së voni brenda afatit shtatë ditë nga arritja e saj në gjykatë. Meqenëse neni 187 i LPK-së, nuk specifikon më tepër lidhur me përgjigjen në ankesë, Gjykata bazuar në LPK-në përcakton në nenin 195 të saj se vendimet që merren nga gjykata e shkallës së dytë, në rastin konkret Gjykata e Apelit, janë si në vijim: ta hedhë poshtë ankesën si të vonuar, jo të plotë apo të palejueshme, ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta dhe ta hedhë poshtë padinë, ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta kthejë çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ta refuzoj ankesën si të pathemeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur, ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë.
107. Përveç kësaj, Gjykata vëren se bazuar në nenin 181.1 të LPK-së Aktgjykimi mund të goditet në Gjykatën e Apelit dhe atë:
 - a) për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore;
 - b) për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike;
 - c) për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.”
108. Andaj, duke pasur parasysh dispozitën e lartcekur, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit ka kompetencë të bëjë shqyrtimin e plotë gjyqësor të vendimeve të Gjykatës Themelore lidhur me përgjigjen në ankesë, dhe kjo përfshin çështjet e shkeljes së dispozitave materiale; dispozitave procedurale; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të fakteve; si dhe ka mundësi që ta prishë vendimin e kontestuar dhe të marrë vendim ose ta kthejë çështjen për vendim të ri nga një organ i paanshëm.

109. Prandaj, Gjykata konkludon se Gjykata e Apelit kishte juridiksion të plotë të shqyrtojë të gjitha çështjet e faktit dhe të ligjit që lidhen me kontestin para saj, duke përfshirë edhe qëndrimet e parashtruesit të kërkesës në përgjigjen në ankesë, si dhe kishte kompetencë të anuloi vendimin e Gjykatës Themelore në të gjitha aspektet, duke përfshirë çështjet e faktit dhe ligjit. Prandaj, Gjykata e Apelit, kualifikohet si një “organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë”, në kuptim të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës.
110. Në këtë kontekst, në vazhdim Gjykata do të vlerësoj nëse Gjykata e Apelit, ka vlerësuar argumentet e parashtruesit të kërkesës lidhur me përgjigjen në ankesë dhe pretendimin se Gjykata e Apelit nuk i kishte dhënë mundësi që të përgjigjet në ankesën e Policisë së Kosovës, gjë që ngrit çështjen e parimit të barazisë së armëve.
111. Gjykata fillimisht i referohet aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, i cili për sa i përket shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore ka theksuar që *“Aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të 194 të LPK-së gjeti se: Ankesa e të paditurës është e themeltë. Ankesa e paditësit është e pathemeltë.*
112. Megjithatë, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit në asnjë vend në aktgjykim nuk e përmend përgjigjen në ankesë të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës.
113. Bazuar në arsyetimin e Gjykatës së Apelit, Gjykata vëren se e njëjta përkitazi me përgjigjen në ankesë, ia mohoi të drejtën ligjore parashtruesit të kërkesës sipas LPK-së për t’u deklaruar në lidhje me ankesën e Policisë së Kosovës. Gjykata e Apelit gjithashtu nuk kishte dhënë ndonjë përgjigje specifike në vendimin e saj. Ajo gjithashtu edhe pse kishte “juridiksion të plotë” lidhur me rastin para saj ashtu siç u përcaktua më lart, nuk kishte shqyrtuar specifikisht pretendimet e paraqitura në përgjigjen e tij, duke përfshirë çështjen nëse me këtë rast ishte shkelur parimi i “barazisë së armëve”, që edhe vetë Gjykata e Apelit e kishte vërtetuar në përgjigjen e dërguar në Gjykatë më 18 janar 2023.
114. Gjykata Supreme, lidhur me pamundësinë e deklaramit të parashtruesit të kërkesës në lidhje me ankesën e Policisë së Kosovës, nuk kishte dhënë asnjë arsyetim, përkatësisht nuk e kishte trajtuar këtë çështje. Andaj, duke marrë parasysh pretendimin specifik të parashtruesit të kërkesës lidhur me mos-arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe shkeljen e parimit të “barazisë së armëve” dhe “parimit të kontradiktoritetit” si rezultat i mos trajtimit të këtij pretendimi, përkatësisht përgjigjes në ankesë, kjo e fundit nuk kishte dhënë ndonjë përgjigje konkrete, nëse ky lëshim procedural i Gjykatës së Apelit kishte rezultuar në shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, duke përfshirë parimin e “barazisë së armëve”.
115. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se lidhur me çështjet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës, në përgjigjen e tij në ankesë, Gjykata e Apelit nuk kishte dhënë ndonjë përgjigje specifike në vendimin e saj, përkatësisht nuk e kishte trajtuar fare. Andaj, moskorrigjimi i këtij lëshimi procedural nga Gjykata e Apelit, ngre çështje të rëndësishme të së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, që ngërthen në vete parimin e “barazisë së armëve” si njërin nga parimet themelore të një gjykimi të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, duke pasur parasysh se parashtruesit të kërkesës i ishte mohuar e drejta ligjore sipas nenit 187 të LPK-së që të deklarohet lidhur me ankesën e Policisë së Kosovës, dhe ky lëshim procedural nuk ishte mënjeluar nga Gjykata Supreme pasi as kjo e fundit nuk kishte shqyrtuar specifikisht këto pretendime.

116. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës ishte vendosur në pozitë të pabarabartë në raport me palën kundërshtare pasi kjo e fundit kishte paraqitur dokumente mbështetëse, që ishin të një rëndësie thelbësore për nxjerrjen e vendimit në këtë rast, duke qenë se për këtë arsye edhe është ndryshuar vendimi i shkallës së parë, ndërsa përgjigjen e parashtruesit të kërkesës lidhur me të njëjtën nuk e kishte marrë parasysh Gjykata e Apelit. Në anën tjetër, Gjykata Supreme nuk kishte trajtuar specifikisht e as nuk kishte mënjanuar këtë mangësi procedurale të Gjykatës së Apelit, megjithëse ky ishte njëri nga pretendimet të parashtruesit të kërkesës para Gjykatës Supreme.
117. Gjykata Supreme, pavarësisht çështjes së ngritur nga parashtruesi i kërkesës në lidhje me përgjigjen në ankesë, nuk u mor me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje procedurale dhe në këtë drejtim kjo mund të cenojë “parimin e barazisë së armëve” të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, sa i përket pamundësisë së deklarimit të parashtruesit të kërkesës lidhur me parashtruesin, përkatësisht ankesën e Policisë së Kosovës.
118. Në këtë kontekst, Gjykata ka ripërsëritur se sipas parimit të “barazisë së armëve”, është e papranueshme që një palë në procedurë të paraqesë vërejtje apo komente para gjykatave të rregullta, të cilat kanë për qëllim që të ndikojnë në vendimmarrjen e gjykatës, pa dijeninë e palës tjetër dhe pa i dhënë mundësi palës tjetër të përgjigjet në to. I takon palës së përfshirë në procedurë pastaj të vlerësojë nëse vërejtjet apo komentet e paraqitura nga pala tjetër meritojnë përgjigje (shih, rastin e GJEDNJ-së [*APEH Üldözötteinek Szövetsége dhe të tjerët kundër Hungarisë Mađarske*](#), Aktgjykim i 5 janarit 2011, paragrafi 42).
119. Prandaj, në rastin konkret duke marrë parasysh arsyet e lartcekura, Gjykata konsideron se aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit janë nxjerrë në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse kanë dështuar të mënjanojnë lëshimin procedural që ngrit çështjen e parimit të “barazisë së armëve” përkitazi me atë se, Gjykata e Apelit në aktgjykimin [Ac. nr. 2046/17], i kishte mohuar parashtruesit të kërkesës të drejtën që të deklarohet lidhur me ankesën e Policisë së Kosovës dhe për këtë nuk kishte dhënë ndonjë përgjigje specifike në vendimin e saj.
120. Në këtë kontekst, përveç parimeve tjera, rëndësi i kushtohet edhe dukjes dhe ndjeshmërisë së administrimit të duhur të drejtësisë. Prandaj, duke pasur parasysh këto lëshime procedurale dhe rëndësinë që ka trajtimi i pretendimeve thelbësore të parashtruesve të kërkesës, Gjykata gjen se në rastin e parashtruesit të kërkesës, për shkak të këtij lëshimi procedural ndaj parashtruesit të kërkesës, procedura, shikuar në tërësinë e saj, nuk ishte e drejtë.

Përkitazi me pretendimet tjera të parashtruesit të kërkesës

121. Përveç kësaj, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, përveç pretendimit për shkelje të nenit 31, përkatësisht për shkak të shkeljes së parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, ai gjithashtu pretendon edhe shkeljen e të drejtës për vendim të arsyetuar dhe zbatim të gabuar të ligjit, të gjitha në lidhje me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Megjithatë, Gjykata vëren se këto pretendime përkojnë dhe lidhen me pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës në lidhje me shkeljen e parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve.

122. Duke pasur parasysh që Gjykata sapo ka gjetur shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me shkeljen e parimit të “barazisë së armëve”, konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, sepse ato në parim lidhen me pretendimin për “barazi të armëve”. Megjithatë, pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës duhet të shqyrtohen nga Gjykata e Apelit në përputhje me gjetjet e këtij aktgjykimi.

Përfundim

123. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit është nxjerrë në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit procedural.
124. Gjykata, bazuar në konstatimin e saj se Gjykata e Apelit ka shkelur parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit procedural duke mos marrë parasysh përgjigjen ndaj ankesës së parashtruesit të kërkesës, të cilën ai e ka paraqitur brenda afatit ligjor, vlerëson në vijim se nuk është e nevojshme të shqyrtohen: (i) pretendimet tjera të parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për sa i përket zbatimit të gabuar të ligjit dhe mungesës së një vendimi të arsyetuar gjyqësor, pasi ato duhet të shqyrtohen nga Gjykata e Apelit në përputhje me konstatimet e këtij aktgjykimi.
125. Në fund, Gjykata konsideron se ky përfundim ka të bëjë ekskluzivisht me pretendimet lidhur me shkeljen e paragrafit 1, të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 të KEDNJ-së, konkretisht për shkeljen e së drejtës për barazi të armëve në lidhje me garancitë procedurale përkitazi me mosshqyrtimin e përgjigjes në ankesë dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e rastit në merita.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 25 korrik 2023, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, njëzëri, se ka pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- III. TA SHPALLË TË PAVLEFSHËM, njëzëri, Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 584/2021 të 22 prillit 2021 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 2046/17 të 9 korrikut 2020;
- IV. TA KTHEJË, njëzëri, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 2046/17 të 9 korrikut 2020 për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;
- V. TA URDHËROJË Gjykatën e Apelit që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 60 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës, deri më 25 janar 2024;
- VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;
- VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë atë në Gazetën Zyrtare;
- VIII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Bajram Ljatifi

Gresa Caka-Nimani

